



RÖFIX Fino me gurë shumëngjyrësh-

Fino dekorative për xokolaturë

Udhëzime teknike dhe ligjore:

Gjatë aplikimit të produkteve tona, respektoni të dhënat në skemat teknike, të cilat janë në përputhje me standardet e përgjithshme dhe specifike të vendit (UNI, ÖNORM, SIA, etj), si dhe të merren parasysh rekomandimet e shoqatës kombëtare të specialistëve (p.sh. SMGV, ÖAP, QG -WDS).

Fushat e përdorimit:

Fino dekorative për muret, e gatshme, e përgatitur në fabrikë dhe përzier në makineri me efektin „MultiColor“ dhe „suvasë që fshihet“
Suva zbukurimi e fortë dhe e qëndrueshme, mbi suvanë mbushëse në zonën e xokolaturës/beton, në mure të brendshme dhe të jashtme, në porta, shtylla, shkallë shtëpie por veçanërisht për zonën e xokolaturës.

Karakteristikat:

- Rezistent ndaj fërkimeve
- Zgjedhje e madhe nuanca ngjyrash
- Qëndrueshmëri e lartë ndaj kushteve atmosferike
- Qëndrueshmëri e lartë

Përpunimi:

Të dhëna teknike						
SAP-Art. Nr.:	2000149534	2000149535	2000150735	2000150737	2000150739	2000150740
NAV-Art. Nr.:	117040	117041	117044	117049	117051	117052
Lloji i paketimit						
Njesi per palete	24 Nj./Pal					
Sasi për njësi	25 kg/Nj.					
Ngjyra	me ngjyra					
Struktura e suvasë	V					
Kokrrizimi	1,8 mm					
Konsumi	ca. 5 kg/m ²					
Dëndësia në gjëndje të papërpunuar	1.600 kg/m ³					
Vlera e pH	8,5					
Kapaciteti termik	1 J/kg K					
Kapilariteti	< 0,15 kg/m ² h					
Këshilla për paketimin	Në kova plastike të riciklueshme					
Temperatura e bazamentit	> 5 - < 25 °C					

SAP-Art. Nr.:	2000150741	2000150742
NAV-Art. Nr.:	117053	117060
Lloji i paketimit		
Njesi per palete	24 Nj./Pal	
Sasi për njësi	25 kg/Nj.	
Ngjyra	me ngjyra	
Struktura e suvasë	V	
Kokrrizimi	1,8 mm	
Konsumi	ca. 5 kg/m ²	



RÖFIX Fino me gurë shumëngjyrësh-

Fino dekorative për xokolaturë

SAP-Art. Nr.:	2000150741	2000150742
Dëndësia në gjendje të papërpunuar	1.600 kg/m ³	
Vlera e pH	8,5	
Kapaciteti termik	1 J/kg K	
Kapilariteti	< 0,15 kg/m ² h	
Këshilla për paketimin	Në kova plastike të riciklueshme	
Temperatura e bazamentit	> 5 - < 25 °C	

Baza e materialit:

- Mjete lidhëse me dispersion
- Rërë kuarci (e ngjyrosur)

Kushtet e punimit: Gjatë fazës së tharjes dhe përpunimit, temperatura e ambientit dhe bazamentit nuk duhet të bjerë nën +5 °C.
Deri sa të arrihet tharja e plotë, mbrojeni nga ngrirja, tharja e shpejtë (rezatimi direkt i diellit, era) dhe shiu.
Lagështia e ambientit nuk duhet të kalojë 65 % lagështi e mbetur gjatë fazes së aplikimit dhe tharjes.

Bazamenti: Bazamenti duhet të jetë i thatë dhe i pastër, me aftësi mbajtëse si dhe pa papastërti si p.sh. pluhur, alga, blozë, kripra etj. .
Në rast suvash të reja të sapo shtruara (psh gëlqere apo çimento) në varesi të rregullave të prodhimit duhet respektuar një kohe tharje prej min 2-3 jave.
Testimi i bazamentit duhet të vijojë sipas ÖNORM B3346 ose DIN 18350 ose SIA V242.
Bazamente me aftësi thithëse të ndryshme mund të cojnë në diferenca të dukshme optike të sipërfaqeve (p.sh. pjesë të ndritshme, diferenca ngjyrash, etj.).

Bazamenti Trajtimi paraprak:

Suva mbushëse me bazë gëlqere: Mos e përdorni në këto bazamente
Suva mbushëse me bazë gëlqere /çimento: I përshtatshëm
Suva mbushëse e lehtë:
Suva termoizoluese: Mos e përdorni në këto bazamente
Beton: Për bazamente të sheshta
Sisteme të izolimit termik, suva të izolimit termik, bazamente elastike: I përshtatshëm
Suva e vjetër me bazë minerale e palyer: Për suva rinovuese (Renostar, Renoplus)
Suva e vjetër me bojë minerale: Për suva rinovuese (Renostar, Renoplus)
Suva e vjetër organike: Për suva rinovuese (Renostar, Renoplus)
Suva mbushëse me bazë allçije e thatë: I përshtatshëm
Pllaka karton gipsi: për këtë shiko kapitullin 4, suvatë e sipërme/finot
Pllaka allçije me fibra letre (p.sh. Fermacell): për këtë shiko kapitullin 4, suvatë e sipërme/finot

Bazamenti-Trajtimi paraprak: 24 orë përpara aplikimit të finos aplikoni astarin RÖFIX PREMIUM mbi bazament me furcë ose rul, të pa holluar, në të gjithë sipërfaqen.
Shtresat e bojrave të vjetra të cara dhe të dala ngjyrë duhen larguar mekanikisht.
Bazamentet me gradë thithëse të ndryshme paratrajtojini me astarin e përshtatshëm RÖFIX pa tretesa (PP 201 ,PP 301 dhe PP 401). Astarët hollohen me ujë, në mënyrë që të thithen nga bazamenti për të shmangur formimin e filmit të vazhdueshëm (shih skedën teknike).
Bazamentet e paniveluara mund ti niveloni me masën shpatulluese (psh. RÖFIX Renoplus, Renostar)

Përgatitja: Produkt i gatshëm për përdorim
Mos e holloni
Përpara aplikimit përzieni mirë prodhimin në enën e tij me një përzierës mekanik me rrotullime të ngadalëta
Përzieni për pak kohë. Evitoni një përzierje të tepërt.
Për të përzier mos përdorni përzierësa me alumin (mundësi krijimi njollash)



RÖFIX Fino me gurë shumëngjyrësh-

Fino dekorative për xokolaturë

Përpunimi:	<p>Shtrimi kryhet me anë të një mistrie inoksi të lëmuar nga poshtë lart në rreth 1 ½ e trashësisë së kokrrizës. Në gjëndje akoma të lagur shtrohet në të njëjtin drejtim me të njëjtën vegël.“ Në sipërfaqet e suvatimit të lidhura me njëra tjetrën aplikohet pa ndërprerje „e freskët mbi të freskët“ Mistri</p>
Këshilla për heqjen e mbeturinave:	<p>Për të mënjeluar ndryshime në ngjyra dhe parregullsi sipërfaqësore, mos përdoreni mjete të ndryshme për aplikim. Pjesët kufizuese të ndërtesës (si dyer, dritare korniza dritaresh etj) përgjithësisht duhet të mbulohehen para punimeve për të mënjeluar ndotjen ose korrozionin. Ju lutem merrni parrasysh rregulloren aktuale të shoqatës austriake të suvatimit “rregullat e aplikimit të suvave të sipërme” Ju lutem merrni parrasysh rregulloren aktuale të shoqatës austriake të suvatimit “rregullat e aplikimit të suvave të sipërme”</p>
Këshilla në rast reziku:	<p>Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.</p>
Këshilla për përpunimin:	<p>Në varësi të lagështisë së ajrit dhe temperaturës koha e lidhjes zgjat rreth 3 ditë. Koha e tharjes së plotë zgjat rreth 3 javë. Sipërfaqe me shtresa të reja duhet të mbrohen deri në lidhjen e plotë të tyre nga lagështira, nëpërmjet masave përkatëse. Lagështia e lartë e ajrit ose e masës mund të krijojë një turbullim të përkohshëm (e bardhë - si qumësht) Nje lyerje baze e ngjyrosur e pershtatshme është mire të përdoret si rregull. Lagështia e ambientit nuk duhet të kalojë 65 % lagështi e mbetur gjatë fazes së aplikimit dhe tharjes.</p>
Magazinimi:	<p>Magazinojini në vende të freskëta, ku nuk kanë mundësi të ngrijnë dhe të jenë të mbyllura hermetikisht. Magazinimi min. 24 muaj.</p>



RÖFIX Fino me gurë shumëngjyrësh-

Fino dekorative për xokolaturë

Këshilla të përgjithshme:

Kjo skedë teknike anullon dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme.

Të dhënat e këtyre udhëzuesve teknike përkojnë me njohuritë dhe përvojën tonë praktike të deritanishme.

Ky informacion dhe të dhënat janë përpiluar me kujdes dhe me ndërgjegje të plotë, por pa mbajtur përgjegjësi për vendime ose veprime plotësuese që mund të marrë vetë konsumatori. Të dhënat në veteve nuk provojnë asnjë lidhje ligjore ose detyrime të tjera anësore, dhe normalisht nuk e ndalojnë konsumatorin të testojë produktin për ato qëllime për të cilat edhe është prodhuar.

Tek finot pastoze forca në shtypje duhet të jetë minimumi 1,5 N/mm². Mos e përdorni në bazamente të lagështa dhe jo mbi sipërfaqe që janë në kontakt të shpeshtë me ujin. Nuk mund të thuhet se mund të kemi një tharje të bazamentit dhe pa njolla për shkak të kushteve të objektit dhe motit. Për shkak të përdorimit të lëndëve të para natyrore ndryshime të vogla të ndryshimit të ngjyrës janë të mundshme. Objektet që janë të lidhur me njëri tjetrin duhet të lyhen nga i njëjti furnizim/ porosi që të shmangim diferencat në ngjyrë. Në rast se do punohet me të njëjtën ngjyrë për një kohë të gjatë në kantier duhet ti jepet prodhuesit data e porosisë së parë. Materialet e magazinuara mund të shkaktojnë ndryshim ngjyre. Ju lutem përpara aplikimit kontrolloni ngjyrën. Ankesat e mëvonshme nuk mund të merren parasysh.

Agjentët atmosferikë, rrezet UV, ekspozimi nga lagështia ndryshojnë sipërfaqen me kalimin e kohës. Ndryshime të dukshme të ngjyrës janë të mundshme. Ky proces ndryshimi ndikohet nga materiali dhe kushtet e objektit.

Kur fasada nuk është tharë ende, vesa, shiu mund të depozitohen në sipërfaqe. Efekti është i ndryshëm në varësi të intensitetit të ngjyrës i cili ndryshon. Dhe nuk ka ndikim në cilësinë e produktit. Efektet zhduken nga erozioni.

Produktet RÖFIX si dhe të gjitha materialet përbërëse, i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm, me anë të të cilit garantohet një cilësi e pandryshueshme.

Stafi ynë është i gatshëm tju japë cdo ndihmë teknike në lidhje me përdorimin, përpunimin si dhe mund të ofrojë edhe trajnime praktike në lidhje me përdorimin e produkteve tona.

Vlerat teknike janë bazuar tek produktet bazë. Gjatë pigmentimit ose ngjyrosjes, janë të mundshme edhe devijime nga të dhënat teknike. Në dhënien e vlerave bëhet fjalë për vlera mesatare. Meqënëse produktet tona përbëhen nga materiale natyrore, mund të ndodhë që në një ngarkesë të kemi edhe devijime minimale të vlerave. Për veshjen e sipërfaqeve, të cilat këtu nuk janë përshkruar, do të ishte i nevojshëm një marrje mendimi nga ana jonë. Në rast porosie plotësuese ose në lidhje me katalogun e ngjyrave, pigmentet mund të ndryshojnë minimalisht, prandaj dhe në kantieri duhet të bëni si fillim një mostër për krahasim. Të dhënat në lidhje me kohën e pritjes-veprimit janë percaktuar në kushtet e laboratorit (20°C/65%Lageshtirë/e mbetur) dhe sipas kushteve të kantierit mund të ndryshojnë.

Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.